

Data 28.03.2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “GOMA”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** Goma për automjete të lehta 34351000-2

**VLERA E FONDIT LIMIT: 1.814.900** (Një milionë e tetëqind e katëmbëdhjetë mijë e nëntëqind) lekë pa t.v.sh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Gjirokaster** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formular oferte*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

## 2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

---

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe nenit

.....  
(Shënim: *përcaktoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).*

## 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare. 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në vlerën e fondit limit, vlera është nën kufirin e ulët monetar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

**2.2.2.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020,2021, 2022 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika "c", të ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe neni 41, pika "c", e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20. % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë mbi garancinë e gomave jo më pak se 50.000 (pesëdhjetë mijë) kilometra. Shoqërit gjatë periudhës së garancisë janë të detyruara të kryejnë zëvendësimin e gomave me difekte për shkak të prodhimit ose cilesisë së dobët, pas marjes së njoftimit nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Gjirokaster.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të paraqesin një produkt cilësor.

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit dhe shpërndarjes së mallrave, në adresat e drejtorive në varesi të autoritetit kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesit, për mallrat objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të

permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, e-mail, Eëbsite kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana etj.

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, **ISO 9001:2015 për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë / ekuivalente dhe e vlefshme.** Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

**V111AAD 249,500**

**V328AAC 251,000**

**V314AAB 33,200**

**V510AAE 978,000**

**V912AAC 83,200**

**V424AAF 196,000**

**V426AAB 24,000**

**Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të ofertojnë sipas kodeve përkatëse në preventiv. Në të kundërt përbën shkak për skualifikim.**

Sqarim

AK për të bërë sa më të thjeshtë procesin e verifikimit të gjendjes gjyqësore për anëtarët e organit administrativ, drejtuesit ose mbikqyrësit aksionerit ose ortakut ose ka kompetenca përfaqësuese , vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik këkon nga ana e operatorëve ekonomik për të deklaruar ID e personave të cilët do të deklarohen në Shtojcën 8 të Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit për këtë verifikim.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

### **Specifikimet teknike:**

1. Gomat te jene te reja (te pa riveshura)

2. Ne siperfaqen anesore, cdo gome duhet te kete te stampuar keto te dhena:

- Prodhuesi (marka)
- Emertimi i gomes
- Permasat e gomes (sipas kerkesave) dhe profile i bratistrates
- Indeksi i ngarkeses dhe i shpejtesise
- Struktura e gomes (radiale ose diagonal)
- Tipi i gomes ( **Tubless / Tube Type**)
- Numri i miratuar **UN/ECE** I prodhuesit te gomes ( tregon se prodhimi i gomave behet ne perputhje me regullat e vendosura nga UN/ECE)
- **E** (standarti i BE) ose **DOT** ( standarti amerikan)
- Kodi i prodhuesit te gomes.
- Kodi i gomes (per shembull EA—Kodi i gomes **295/80R 22.5, 315/80R 22.5**)
- Data e prodhimit ( per shembull 1009—prodhuar ne javen e dhjete te vitit 2009)

3. Te jene te prodhuara jo me heret se 6 muaj nga data e zhvillimit te tenderit.

4. Gomat e nje dimensionit te jene 50% goma per aksin e pare dhe 50% per aksin e dyte .

- pra per aksin e pare goma verore
- dhe per aksin e dyte goma dimerore ose peshe

5. Gomat te mos jene te riveshura.

6. Gomat e fadromave (skrepa) duhet te jene :

Fadroma Fiat Hitachi me numer gome 18.4-26-Industriale 16 fije (shtresa) dhe 24 dhembe.

Fadroma Benati me numer gome 16.9-24 –Industriale 16 fije (shtresa).

### **Garancia**

1. Garancia jo me pak se 50.000 (pesedhjete mije) kilometra. Shoqerit gjate periudhes se garancise jane te detyruara te kryejne zevendesimin e gomave me difekte per shkak te prodhimit ose cilesise se dobet, pas marjes se njoftimit nga enti i pritjes se mallit.

Kujdes!

Ne cdo raste qe do te verifikohet nga komisioni i marjes ne dorzim qe gomat nuk ju permbahen specifikave,datave te dhenave dhe cilesis,nuk do te meren ne dorzim nga ky komision.

*Keto specifikime teknike jane vendosur ne menyre qe te garantojne cilësinë e kërkuar, dhe që vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

## **NJËSI E PROKURIMIT**

**Alfons Alikaj**

**Alma Llaci**

**Lorjana Shehu**